



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:129857  
Datë: 30.04.2024  
Numri i dokumentit: 05644298

KPPP.nr.2017/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Gent Bekeri, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Bashkimi Projekt” me NUI 810799504, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokat Arian Prebreza me seli në Fushë Kosovë, kundër debitorit “Sollabaj” Sh.p.k me NUI 811381144 të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokat Vyrtyt Ibrahimaga me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.35/22 të datës 20.05.2022, të Përmbartuesit Privat Saranda Kuçi, me seli në Prizren, jashtë seancës, me datë 30.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit “Sollabaj” Sh.p.k, ANULOHET urdhri përmbartimor P.nr.35/22 të datës 20.05.2022, të Përmbartuesit Privat Saranda Kuçi, dhe PËRFUNDOHET në tërësi përmbartimi në këtë çështje përmbartimore.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat Saranda Kuçi me seli në Prizren, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Bashkimi Projekt”, ka caktuar Urdhrit Përmbartimor P.nr.35/22 të datës 20.05.2022, duke lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm – faturës me numër 0036 e datës 22.09.2020, me të cilin e ka urdhëruar debitorin, që në emër të borxhit sipas faturës së lartcekura, t’ia paguaj shumën prej 50,000.00 €, me kamatë ligjore prej 8% deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, e ka kundërshtuar në tërësi propozimin për përmbartim, ndër të tjerash ka theksuar debitori nuk ka as një obligim të hapur ndaj kreditorit, i njëjti nuk ka paraqitur as një dëshmi për dorëzimin e kësaj fature tek debitori,

dhe debitori nuk është në dijeni për ekzistimin e një fature të tillë, andaj në mungesë të një dokumenti përmbartimor mbi cilën bazë ka lejuar përmbartuesi përmbartimin, në fund i ka propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi i debitori ndërsa urdhri përmbartimor të anulohet.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim, pasi që prapësimi i debitorit nuk është në pajtueshmëri me nenin 71 të LPP-së, lidhur me dokumentin përmbartimor, fatura në origjinale i është dorëzuar përmbartuesit privat dh enë bazë të saj është lëshuar urdhri përmbartimor dhe se debitori është i njoftuar me obligimin dhe faturën të cilën e posedon, ndërsa fatura si dokument përmbartimor i plotëson konditat sipas nenit 29 të LPP-së në fund i ka propozuar gjykatës që të refuzohet në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit ndërsa urdhri përmbartimor të mbetet në fuqi dhe i ka kërkuar shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, të përgjigjes në prapësim si dhe shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) dhe nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 Për Procedurën Përmbartimore, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbartimor duhet të anulohet dhe procedura përmbartimore të përfundohet në tërësi për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se organi përmbartues ka lejuar përmbartimin bazuar në nenin 21 të LPP-së i cili përcakton se: *“Organi përmbartues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbartimin vetëm në bazë të dokumentit përmbartues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër.”*

Gjykata vlerëson se në rastin konkret – fatura me numër 0036 e datës 22.09.2020, në bazë të cilës është lejuar urdhri për përmbartim, nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “*, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për*

*përmbarrim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.*”, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbarrimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se dokumenti fatura, në bazë të cilës është lejuar propozimi për përmbarrim nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se fatura në rastin konkret është lëshuar në mënyrë të njëanshme nga ana e kreditorit dhe nuk është pranuar nga debitori, përkatësisht e njëjta nuk përmbajnë nënshkrimin apo vulën e pranuesit – debitorit dhe nuk ka dëshmi se e njëjta është pranuar nga debitori në ndonjë mënyrë tjetër. Andaj, duke qenë se debitori nuk e ka pranuar në mënyrë të rregullt faturën, si e tillë e njëjtat nuk mund të shërbejnë si dokumente i besueshme dhe nuk ka tipare të përmbarrueshmërisë.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumentet e besueshme, mbi të cilat mbështet propozimi për përmbarrim, e mbi bazën e të cilave Përmbarruesi privat ka lejuar përmbarrimin, nuk ka tipare të përmbarrueshmërisë dhe si rrjedhojë edhe urdhri i lejuar nga ana e përmbarruesit duhet të anulohet dhe procedura të përfundohet në tërësi.

Gjykata i vlerësoj pretendimet e kreditorit paraqitur në propozim dhe përgjigje në prapësim, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk mund të jenë objekt shqyrtimi i procedurës përmbarrimore prandaj dhe nuk mund të vlerësohen në këtë procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të formalitetit rigoroz, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumenteve në bazë të cilave është lejuar përmbarrimi, si dhe përshtatshmërisë së dokumentit objekt përmbarrimi.

Gjykata në kuptim të nenit 71 par. 1.1 dhe 73 të LPP-së, nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.2017/22, datë 30.04.2024

Gjyqtari

Gent Bekeri

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.